

KONTRIBUT PËR NDRIÇIMIN E ETIMOLOGJISË SË QYTETIT PRISHTINA

Jahja DRANÇOLLI
Fakulteti Filozofik-Prishtinë

KUD:809.198.3:801.54
Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Në një akt apo diplomë mesjetare, që mban datën e vitit 1071, përmendet termini *Pristinum*, që mund të ketë të bëjë me ndonjë lokalitet. Një paraqitje e kësaj fjale, që i referohet ishullit *Arbe*, shpie të mendohet edhe në ekzistimin e Prishtinës gjatë antikitetit dhe gjatë mesjetës.

Vlera burimore e dokumenteve historike është e shumëfishtë. Për rëndësinë e tyre kemi bërë fjalë në ndonjë rast tjetër. Në këtë studim do t'i spikasim vlerat e tyre në lëmin e onomastikës. Që këtej, në një dokument (akt,diplomë), që mban datën 1071, lexojmë pasazhin: "*Pristinum (J.D.) uero rogamus dari Maçulino, Arbensi comiti qui noster est. Que omnia volumus ut dictum monasterium excepto nominato pristino habeat (...)*".¹

Në historiografi e zë ngoje për herë të parë këtë akti historiani Joannis Lucii². Mirëpo, për herë të parë u botua nga D.Farlatti në një përmbledhje dokumentesh me përmbajtje kishtare.³ Pas tij, këtë dokument e botuan edhe studiuesit e shquar I Kukuljeviq Sakcinski, F.Raçki, G.Parga, etj.⁴ Nga të gjitha botimet në fjalë, del qartë se akti i referohet princit të Arbës (sot ishulli Rab në Kroaci-J.D.). Mirëpo, është me interes të dimë se çka është *pristinum*, që përmendet po në këtë akt? Pasazhi i tekstit latin, që u përmend më sipër, veçanërisht fjala *pristinum* tërhoqi vëmendjen e shumë studiuesve prej gjysmës së dytë të shekullit XIX deri në ditët e sotme. Kështu, studiuesi I.Kukuljeviq-Sakcinski mendon se është

¹ F. Rački, *Documenta historiae Chroatae periodum antiquam illustrantia*, in MSHSM VII,Zagrabiae 1877, p. 89-90.

² Joannis Lucii, *De Regno Salmatae et Croatiae libri sex*, Amstelodami 1661, lib. III. cap. XII, p. 142.

³ D. Farlatti, *Illyricum Sacrum V*, Venetiis MDCCLXXV, p. 229.

⁴ I. Kukuljević-Sakcinski, "Diplomatički zbornik kraljevine Hrvatske s Dalmacijom i Slavonijom", I, Zagreb 1874, p.140; F. Rački, op. cit., p. 89-90; G. Praga, *La traslazione di S.Niccolò e i primordi delle guerre Normanne in Adriatico*, in Archivio storico per la Dalmazia XI, p.128-129.

fjala për ndonjë dhuratë kishe.⁵ Ndërkaq, medievistja e shquar Nada Klaić mendonte se fjala apo termini *pristinum* "duhet të përcaktonte ndonjë lokalitet",⁶ që nuk figuron në pronën e dhuruar. Fjalës *pristinum* i sillen edhe paleografët e shquar I.Stipishiq dhe M.Shamshalloviq, të cilët nuk dyshonin në transkribimin dhe transliterimin e drejtë të fjalës *pristinum*. Sipas mendimit të tyre dhe duke pasur parasysh studimet e bizantologut Du Cange, është e qartë se është fjala "për disa dhurata princit të Arbës, të cilat njëkohësisht shpjegojnë kuptimin e fjalës *pristinum-pristina*".⁷ Në anën tjetër, studiuesi F.Rački është i pari, i cili mendon se fjala *pristinum* është transkribuar gabimisht, dhe se, në vend *pristinum* duhet të lexohet *pristavum*.⁸ Këtë rrugë të gabueshme e ndoqën edhe studiuesit V.Mazhuraniqi,⁹ A.Dabinoviqi,¹⁰ si dhe albanologu dhe ballkanologu i madh M.Shuflaj.¹¹

Është me interes të theksohet se fjala *pristinum* përmendet edhe në dokumente mesjetare të dialektit dalmatin. Në këtë aspekt supozimet për transkribimin jo të drejtë të fjalës *pristinum* apo dyshimit për lëshime teknike-materiale të noterit, që shkroi aktin, nuk kanë mbështetje shkencore. Mirëpo, na duket se rezultatet e deritanishme mund të plotësohen me sukses dhe të arrihet në zgjidhjen e enigmës, nëse merren në konsiderim edhe të dhënat që ofrojnë burimet bizantine, perëndimore dhe arabe të kohës.

Dhe me të vërtetë, në përmbajtjen e të ashtuquajturës përmbledhje *Liber Albus* fshihen marrëveshjet midis Venedikut dhe partnerëve të tij lindorë (Bizantit, shteteve kryqtare dhe arabe). Kjo përmbledhje u shkrua në shek. XIV sipas kërkesës së dukës A.Dandolo.¹² Në të ruhet e shtypur sërish bula e perandorit bizantin Emanuel Komnenit nga viti 1148 dhënë Venedikut. Teksti i kësaj bule ruan përmbajtjen e bulës së artë të perandorit Aleks Komnenit nga viti 1092, por e ruajtur fatkeqësisht vetëm

⁵ I. Kukuljević-Sakcinski, op.cit., p. 140.

⁶ N. Klaić, *Rapski falsifikati*, in "Zbornik Instituta za historijske nauke u Zadru", Zadar 1955, p. 46-48.

⁷ J. Stipišić-M. Šamšalović, "Diplomatički zbornik Kraljevine Hrvatske, Dalmacije i Slavonije", I, Zagreb 1967, p. 124-126.

⁸ F. Rački, op. cit., p. 90.

⁹ V. Mažuranić, *Prinosi za hrvatsku pravno-povjestni rječnik*, Zagreb 1908-1922, p. 1151-1152.

¹⁰ A. Dabinović, *Hrvatska državna i pravna povijest*, Zagreb 1940, p. 134.

¹¹ M. Šufflay, *Die dalmatinische Privaturkunde, Sitzungsberichte der Kais. Akad.der. Wiss. Phil.-hist.Klasse B. CXLVII*, Wien 1904, p.35.

¹² H. Kretschmayr, *Geschichte von Venedig I*, Gotha 1905, p. 397.

në gjuhë latine. Sipas tekstit të ruajtur në *Liber Albus*, A.Komneni ua dhuroi venedikasve, sidomos dukës së Venedikut dhe institucioneve të ndryshme venedikase shumë privilegje. Në këtë kuadër ndeshim edhe këtë dispozitë: "Donat autem et sancto Akindino mankipium i.e. *pristinum* (J.D.), quod est in ipsius ecclesie latere, quod est in ipsius ecclesie latere, quod pertinet ad domum Petrii et habet pensionem byzantinorum XX".¹³

Gjithsesi, këtu është fjala për ndonjë dhuratë të rëndësishme pronësore, meqë perandori bizantin nuk do të kishte vënë në bulë të artë. Fjalën *pristinum*, të cilën botuesit G.L.Fr.Tafel-G.M.Thomas e zëvendësojnë me fjalën *pistrina*, në tekstin latin të bulës së artë të perandorit Aleks e barazojnë me fjalën *mankipium*.¹⁴ Ndërkaq, fjala *mankipium* sipas gjuhës mesjetare bizantine ka kuptimin e furrës për bukëpjekës. Bizantologu i njohur i shek.XVII Du Cange në një vepër të tij me vlera monumentale e shpjegon këtë fjalë kështu: **μαγκίπιον, ἀστοποιητικόν, ἐργασίριον, pistrinum**, duke ofruar për këtë çështje shumë shembuj nga burime mesjetare bizantine.¹⁵ Ndërkaq, në një studim tjetër të po këtij autori, ku trajtohen çështje nga latiniteti mesjetar,¹⁶ fjalën *manceps-pistor publicus* shpjegon: **μάγκιψ, ὁ τεχνίτη τοῦ δημῶδου ἄρτου**, bashkë me këtë ofron edhe disa vërejtje të rëndësishme të studiuesit J.Gotofred. Në të vërtetë, që në antikitet fjala *manceps* mes tjerash ka edhe kuptimin e bukëpjekësit. Këtej, fjalët *pistoria*, *pistores* dhe *manceps* ishin ngusht të lidhur me antikitetin.¹⁷

Sipas **ἐπαρχικὸν βιβλίον** të perandorit bizantin Luanit të Ditur.¹⁸ në të cilin jepen dispozitat mbi korporatat në Kostandinopojë, bukëpjekësit paraqisnin një korporatë të pavarur për të cilën bëhet fjalë

¹³ G. L. Fr. Tafel-G.M.Thomas, *Urkunden zur älteren Handels-und Staatsgeschichte der Republik Venedig mit besonderer Beziehung auf Byzanz und die Levante*, in "Fontes rerum austriacarum XII", Bd. Wien 1856, p.121.

¹⁴ G.L.Fr.Tafel-G.M.Thomas, op.cit.,p.121.

¹⁵ Ch. Du Cange, *Glossarium ad scriptores mediae et infimae graecitatis I*, Parisiis MCLXXXVIII, cOLL. 846.

¹⁶ Du Cange Ch, du Fresne, *Glossarium mediae et infimae latinitatis*, 3 vol. Parisiis 1678; 10 vol., Niort 1882-1887; vol., Paris 1937-1938; 5 vol. Graz 1954; A. Bartal, *Glossarium mediae et infimae latinitatis ragni Hungariae*, Lipsiae-Budapestini 1901; P.Sella, *Glossario latino-italiano-Stato della Chiesa*, Veneto, ect. 1944.

¹⁷ V. Codex Iustinianus, 11,16, 1 *De pistoribus* nga vitet 457-465; Cfr. Paul. Digesta, 27,1,46, shembulli: *pistrinum*, dhe Codex Iustinianus 11, 24,1,viti 416: *mancipum*.

¹⁸ V.J.D dhe P.I. Zepos, *Jus Graecoromanum,2,Leges imperatorum Isaurorum et Macedonum*, p.371-391.

në kreun e XVIII, që mban titullin *περι τῶν ἀρτοποιῶν ἤτοι μαγκίπων*, ku shpjegohet se si bukëpjekësit bluanin grurin dhe pastaj piqnin dhe shisnin bukë. Këtej, është për të vënë re se, gjatë mesjetës zeja e bukëpjekësit ishte e lidhur ngushtë me bluarjen e grurit në mulli, gjë që praktikohet edhe gjatë antikitetit. Nga dispozitat e Luanit të Ditur mësojmë gjithashtu edhe për çështjen se mullinjtë, në të cilët bluanin bukëpjekësit, veheshin në lëvizje me kafshë.¹⁹ Nga kjo del se, sipas tekstit latin të bulës së artë të perandorit bizantin Aleks, fjala *mankipium* është identik me *pristinum* përkatësisht fura e bukëpjekësit është e lidhur me mullirin, të cilin e lëviste kafsha, gjë që shpjegohet bukur mirë se *pristinum* nga akti i vitit 1071 do të kishte përmbajtje të njëjtë.

Përmbajtja që ofron akti në fjalë i vitit 1071, do të ketë edhe vlera më të mëdha shkencore për etimologjinë e qytetit Prishtina, sidomos kur dihet mirëfilli se treva iliro-shqiptare e Kosovës, gjatë gjithë mesjetës ishte e lidhur në mënyrë reciproke ngushtë me Bizantin dhe me shtetet rreth Adriatikut (Raguzën, Venedikun) gati në të gjitha sferat e jetës. Andaj, është shumë e natyrshme që edhe në trevën e Kosovës të ndeshim fjalë e termine që korrespondojnë me leksikun e të gjitha trevave të afërta, ku vazhdonte jeta e qytetëruar që nga antikiteti, çështje për të cilën kanë folur shumë studiues të njohur. Në këtë aspekt nuk kanë mbështetje shkencore gjykimet e ndonjë studiuesi për etimologjinë sllave të qytetit Prishtina, aq më tepër kur dihet se serbët në Kosovë e vendosën pushtetin e tyre në fillim të shek. XIII, ku popullate e tyre paraqiste, atëbotë dhe në shekujtë e mëvonshëm një pakicë të parëndësishme, ndërkaq fjalën *pristinum-pristina* e ndeshim jo vetëm gjatë mesjetës parasllave, por edhe gjatë antikitetit.

JAHJA DRANÇOLLI

A CONTRIBUTION FOR ENLIGHTENMENT OF THE ETYMOLOGY OF THE TOWN PRISHTINA

S u m m a r y

In some documents of the antiquity and of the Middle Ages we can meet the word PRISTINA - PRISTINUM which according to various scholars has several meanings, but none of them can be explained on the basis of the etymology of Slavic languages. According to a document (record) of the year 1071, which refers to the Isle Arbe, every serious scholar would think that the

¹⁹ A. Stöckle, *Spätromische und byzantinische Zünfte*, *Klio* 9, 1911, p. 47.

word PRISTINUM which is mentioned there, should be defined on the basis of a non-Slavic language a certain locality or something similar. In this aspect, we think that we should look for the etymology of the town Prishtina following the example of contents of the document of the Isle Arbe of the year 1071 and some earlier document, and not on the basis of the Slavic etymology, as some scholars might think. Furthermore, it is well-known that the Serbs settled their authority in Kosova at the beginning of the 13th century, and their population presented at that time and in the following centuries only an unimportant minority.

Ne këtë veshtim do të shqyrtojmë disa toponime e antroponime shqiptare mesjetare dhe të sotme, në tëpër të viseve anësore të trojeve etnike shqiptare siç janë në Ma të Zi, në Sanxhakun e Nishit ose në Kralupin e Nisaviasë së Serbisë dhe në Visocdoni.

Në Ma të Zi arrijmë të shprehim onomastike të këtyre viseve, qoftë ato dialektale ose onomastike shqiptare qartë ngjashmëria onomastike ose onomastike të cilat janë gjendur në të kaluarën e largët nëpër këto vise të cilatne përfaqësojnë trojeve etnike shqiptare. Sidomos shquhen emrat e disa ish-trajtave të trojeve shqiptare-gjuhësore shqipe, po të trajtave të ndryshme fonetike siç janë ato të zhvillimeve të ligjeve fonetike ose si rezultat i shqitimit të tyre me abecetën e huaja në gjubët e huaja kishtare ose të atnjësimit të shqiptarëve të huaj.

Në Keshac në librin e V. Panajotopollosit, që bën fjalë për shumë fjalëra mesjetare shqiptare në Peloponez, përkatësisht për Eliden ose për në Moni shqiptare prej shekullit 13-18, sipas dokumenteve mesjetare i vëm gjetur të shënjuara edhe këto katunde shqiptare: Arvaniza, Arvaniti, Arvania, Arvanit, Arvanocastria, Arha etj¹. Kur jemi të shqiptarëve i vëmaj mënyrë me bazën arv-, arv-, arh-, arn- në emrat e ish-trajtave të nëshqiptarëve. Jam vërejtur se nëpër disa fjalëra me shqiptarë të rrethit të Athinës ende jo përdoretshin nga shqiptarët në shqipe që të dy trajtat, t'i shprehin greke arvaniti dhe arvanitas². Edhe në Çameri, si duket në rreth të Dumenicës, ekziston një katund me këtë rrenjë Arvenica³.

¹ V. Panajotopollos, *Perifoneia qe rrethit nise Arvanites*, (1913) Athina, Adhisa, 1985. (Ky libër transkriptim i kursit në përkthim të librit shqiptarë).

² Përpulsi dhe vendosimet e Peloponezit gjatë shekujve 13-18, f. 299, 307, 310, 315-6, 318, 321, 325, 327. Mirë të cilëve në elikurim PET⁴.

³ Përdorimi i këtyre dy trajtave fonetike arv- e arv- në të kaluarën e largët të trojeve shqiptare e ka të bëjë me atë ditë që shprehin treume onomastike të ligjeve arvanitike në një elikurim të kaluarit në troje të vitit 1285.

⁴ Shih për këtë katund, F. M. Krajal, *Kështjës onomastike të katundit Arvanit*, (1985).

